

RREGULLIMIN E PLATFORMAVE ONLINE NË SHQIPËRI: NJË VESHTRIM KRAHASUES

Arba Xhani; Artemis Senja; Bethni Levandi; Greta Deliallisi; Katerina Çela; Lea Kryeziu;
Leonardo Bezhi; Megi Musabelliu; Oresta Xhengo; Vesa Muka*

Departamenti i Drejtësisë
Universiteti Epoka

Ky punim është autorësi e drejtpërdrejtë e ekipit të disa prej studentëve të Universitetit Epoka. Realizimi i këtij punimi u bë i mundur falë mbështetjes modeste financiare të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, në kuadër të projektit “Jo Korrupsionit, Po Demokracisë”, mbështetur nga Qeveria Suedeze.

1. Hyrje

Në vitet e fundit rrjetet sociale kanë patur një rritje të madhe duke transformuar mënyrën se si individët komunikojnë me njëri-tjetrin. Sipas të dhënave nga faqja *Statista*, në botë janë 5.44 miliardë përdorues aktivë të internetit. Ndërsa, 5.07 miliardë janë përdorues aktivë të rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, Tëitter dhe TikTok.¹

Kjo rritje masive e përdorimit të rrjeteve sociale ka sjellë shumë benefite për komunikimin dhe informimin e individëve por ka ngritur shqetësime të rëndësishme në lidhje me privatësinë, sigurinë dhe ndikimin psikologjik të përdoruesve.² Përdoruesit shpesh ndajnë informacione të

* Studentët janë listuar sipas rendit alfabetik.

¹ Ani Petrosyan, ‘Number of internet and social media users worldwide as of April 2024’ <<https://www.statista.com/statistics/617136/digital-population-worldwide/#:~:text=As%20of%20April%202024%2C%20there,population%2C%20ëere%20social%20media%20us>> aksesuar më 13 qershor 2024.

² Nor Zaina Zaharah Mohamad Ariff, et al. (2018). The Benefits of Using Social Media and the Impact of not filtering the Information. *International Journal of Academic Research in Progressive Education and Development*, 7(3), 304–313; Nicole B. Ellison, Charles Steinfield and Cliff Lampe (2007) The Benefits of Facebook “Friends:” Social Capital

ndjeshme që mund të keqpërdoren nga përdorues të tjerë. Një studim i kohëve të fundit zbuloi se një përqindje e konsiderueshme e përdoruesve kanë përjetuar ose janë të shqetësuar për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale në internet. Gjithashtu rrjetet sociale janë një hapësirë e favorshme për përdoruesit të cilët duan të përhapin lajme të rreme, duke ndikuar kështu në një mjedis të pasigurt informacioni.

Përdorimi i rrjeteve sociale është bërë një pjesë e pandashme e jetës së përditshme edhe për shumë shqiptarë. Megjithatë, me përhapjen e gjerë të këtyre platformave, janë shfaqur disa probleme të rëndësishme. Një shqetësim që shfaqet në Shqipëri, si dhe në shumë vende të tjera, është lidhja midis përdorimit të rrjeteve sociale dhe rritjes së rasteve të vetëvrasjeve, veçanërisht midis të rinjve. Disa nga faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë fenomen janë bulizmi në rrjetet sociale, lajmet e rreme dhe presioni i lartë shoqëror.³ Problemet e përdorimit të rrjeteve sociale në Shqipëri janë komplekse dhe kërkojnë ndërhyrje nga shumë aspekte.

Në Shqipëri, në vitin 2018, kryeministri Edi Rama propozoi rregullimin e mediave dhe platformave online, por pasi u përball me rezistencë nga aktorë lokalë e ndërkombëtarë, si Qendra Evropiane për Lirinë e Medias, Federata Evropiane e Gazetarëve dhe Reporterët pa Kufij, kjo nismë u ndërpre dhe nuk u vazhdua më tej.

Në vijim do të krijojmë një panoramë të përgjithshme sesi Bashkimi Europian, disa shtete që bëjnë pjesë në të apo edhe vëndet në rajon e kanë rregulluar kuadrin ligjor përsa i përket Platformave Online dhe publikimet e paligjshme që mund të bëhen në to.

Ky punim synon të identifikojë domosdoshmërinë e rregullimit ligjor të platformave sociale. Studimi konsiston në analizën e legjislacionit të Bashkimit Europian dhe shteteve që janë pjesë e

and College Students' Use of Online Social Network Sites, Journal of Computer-Mediated Communication, Volume 12, Issue 4, 1 July 2007, Pages 1143–1168; Liu yi Lin B.A., et al, (2017) Association Between Social Media Use and Depression Among U.S. Young Adults, Depression and Anxiety <https://doi.org/10.1002/da.22466>.

³ Ilda Hoxha, 'Dhuna në rrjetet sociale po rrit agresivitetin dhe bullizmin në shkolla' <https://faktoje.al/dhuna-ne-rrjetet-sociale-po-rrit-agresivitetin-dhe-bullizmin-ne-shkolla/> aksesuar më 11 qershor 2024; Ermelinda Hoxhaj, 'Të tallur dhe të dhunuar: Kriza e bullizmit në shkollat shqiptare' (26 shkurt 2024) <https://www.reporter.al/2024/02/26/te-tallur-dhe-dhunuar-kriza-e-bullizmit-ne-shkollat-shqiptare/> aksesuar më 11 qershor 2024.

tij, e nëpërmjet identifikimit të praktikave pozitive do të shqyrtojmë rrugët dhe mjetet më oportune ligjore sesi ata e kanë rregulluar nga ana ligjore këtë problematikë. Më pas, duke studiuar dhe legjislacionin vendas, në këtë punim pasqyrohet një krahasim me legjislacionet e vendeve të BE-së për të kuptuar çfarë mangesish ka legjislacioni ynë e në fund do të ofrojmë rekomandime sesi kuadri ligjor mbi mbrojtjen e përdoruesve në rrjetet sociale mund të përmirësohet.

Punimi përbëhet nga kjo hyrje dhe 5 seksione. Seksioni 2 dhe 3 analizon legjislacionin e Bashkimit European, të disa shteteve anëtare dhe shqipërisë lidhur me rregullimin e platformave online. Seksioni 4 bën krahason dhe identifikon mangësitë e legjislacionit shqiptar. Seksioni 5 paraqet rregullimin e revenge porn nga disa shtete anëtare të Bashkimit European dhe Seksioni i fundit paraqet konkluzionet.

2. Analiza e legjislacionit të BE-së dhe disa shteteve anëtare mbi rregullimin e platformave online

2.1. Bashkimi European

Akti i Shërbimeve Dixhitale është një komponentë kryesor legjislativ i strategjisë dixhitale të Bashkimit Evropian që synon krijimin e një hapësire dixhitale më të sigurt.⁴ Qëllimi i këtij Akti është krijimi i një hapësire dixhitale më të sigurt duke futur rregulla gjithëpërfshirëse për platformat online, duke garantuar sigurinë e përdoruesit dhe duke vendosur llogaridhënie. Ky Akt parashikon se platformat online duhet të zbulojnë politikat, algoritmet dhe praktikat e reklamimit të tyre e të përmbajtjes. Gjithashtu përcaktohen masa më të forta për të parandaluar dhe hequr përmbajtjet dhe shërbimet e paligjshme në internet dhe krijimin e mekanizmave të mbikëqyrjes rregullatore si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë të BE-së.

⁴ Regulation (EU) 2022/2065 of the European Parliament and of the Council of 19 October 2022 on a Single Market for Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 277/1. Për një vështrim të përgjithshëm shiko Commission, *Digital Services Act* <<https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/digital-services-act-package>> aksesuar me 12 qershor 2024.

Një qëllim tjetër është lufta ndaj përmbajtjes së paligjshme në platformat online duke përfshirë propagandën ruse, ndërhyrjen në zgjedhje, krimet e urrejtjes dhe dëmtimet në internet.

Në Aktin Dixhital të BE-së masat e reja janë krijuar për të goditur përmbajtjen e paligjshme duke përfshirë ngacmimin dhe abuzimin e fëmijëve.⁵ Nëpërmjet këtij rregullimi synohet mbrojtja dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njohura me ligj në të gjithë Evropën, duke përfshirë lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e të dhënave. Për prindërit, të cilët nuk janë në gjendje të kontrollojnë gjithçka që sheh fëmija i tyre, ky grup rregullash është më i rëndësishmi. Platformat do të ndalohen të synojnë fëmijët me reklama bazuar në të dhënat e tyre personale. Firmave të mëdha të mediave sociale do t'u kërkohet të ridizajnojnë sistemet e tyre për të siguruar një "nivel të lartë privatësie dhe sigurie të të miturve" dhe të dëshmojnë se e kanë bërë këtë në Komisionin Europian. Platformat do të duhet gjithashtu të ridizajnojnë "sistemet e rekomandimit" të përmbajtjes së tyre për të reduktuar rreziqet për fëmijët. Ata gjithashtu do të duhet të kryejnë një vlerësim të rrezikut të efekteve negative në shëndetin mendor të fëmijëve. Të gjitha platformat që do konstatohen se kanë kryer shkelje do të gjobiten deri në 6 % të xhiros vjetore të vitit paraardhës.

Kompanitë e mediave sociale nuk do të jenë në gjendje të përdorin të dhëna personale të ndjeshme duke përfshirë racën, gjininë dhe fenë për të synuar përdoruesit me reklama. Ky ndryshim erdhi pasi firmat më të mëdha në botë të mediave sociale u akuzuan se përmbajtjet e dëmshme në internet kontribuan në vdekjen e 14-vjeçares Molly Russell në Mbretërinë e Bashkuar.⁶

2.2. Austria

Në vitin 2020, Austria shqyrtoi një ligj të ri i cili do ta bënte të gjurmueshme shkrimin e një postimi me gjuhë urrejtjeje me autorin e tij, e njëkohësisht edhe diçka të detyrueshme për platformat e mëdha të internetit, që të regjistrojnë përdoruesit dhe t'iu heqin atyre mundësinë e fshehjes pas anonimitetit të postimeve me përmbajtje të tillë.

⁵ Akti i Shërbimeve Dixhitale, paragrafet 80-81 të preambulës dhe neni 34.

⁶ BBC, "Molly Russell: Tech firms still failing after teenager's death, says father" < <https://www.bbc.com/news/uk-67556756> > aksesuar më 14 qershor 2024; BBC, "Molly Russell: Coroner's report urges social media changes" <https://www.bbc.com/news/uk-england-london-63254635> aksesuar më 14 qershor 2024.

Kancelari austriak asokohe u shpreh se: “Për fat të keq, kemi pasur një numër në rritje të shkeljeve flagrante, denigrimeve dhe poshtërimeve ‘online’ kohët e fundit, duke u fshehur nën petkun e anonimitetit. Pikërisht për këtë arsye kemi nevojë për një kuadër ligjor që do ta bëjë më të përgjegjshëm lundrimin ‘online’”.⁷

Ligji do të detyronte Facebookun, Twitterin dhe Instagramin që të regjistrojnë përdoruesit e tyre, sipas asaj që ka thënë Gernot Blumel, ministër në detyrë për Marrëdhëniet me BE-në, Artin, Kulturën dhe Mediat. Forma e regjistrimit është një aspekt që do t’iu lihet në dorë platformave gjigante, por autoritetet e këtij vendi do të mund të kenë qasje në identitetin e përdoruesve, në rast konstatimi të një postimi me nota urrejtjeje, apo nëse do të shkeleshin ligjet. “Hapësira ‘online’ vërtet është e pakufizuar, por nuk mund të jetë edhe pa ligje”.

Që një ligj i tillë të funksiononte në Austri, duhet që veç miratimit nga parlamentarët vendas, të miratohet edhe nga Komisioni Europian, për të garantuar se ai është në përputhje me rregulloret e BE-së, sipas të cilave një vend anëtar nuk mund të ketë kufizime ekstra ndaj platformave ‘online’ krahasuar me vendin e origjinës.

Projektligji i propozuar do të aplikohet mbi platformat e internetit që kanë një qasje të konsiderueshme, me mbi 100 mijë përdorues apo 500 mijë euro të ardhura të përvitshme në Austri, sikurse edhe ndaj medieve “online” që sigurojnë më shumë se 50 mijë euro ndihma shtetërore.

Por, edhe në këtë vend, opozita e kishte kritikuar këtë projektligj me justifikimin se kufizon lirinë e shprehjes dhe u ofron gjigantëve si Facebook më shumë të dhëna mbi përdoruesit, ndërkohë që rrjeti më i madh social i botës u vu në qendër të kritikave për mënyrën sesi i menaxhon informacione të tilla private pak kohë më parë.

⁷ IndeksOnline, “Austria, ligj të veçantë për regjistrimin e përdoruesve të internetit” <https://indeksonline.net/austria-ligj-te-vecante-per-regjistrimin-e-perdoruesve-te-internetit/> aksesuar më 10 qershor 2024.

Më 1 Janar 2021 hyri në fuqi Akti i Platformave të Komunikimit i Austrisë (Kommunikationsplattformen-Gesetz).⁸ Ky akt kërkon që platformat online të regjistrojnë përdoruesit dhe të gjurmojnë gjuhën e urrejtjes tek autorët e tyre ka hyrë në fuqi në 1 Janar 2021 pavarësisht të gjitha kundërshtimeve që hasi. Akti i Platformave të Komunikimit u modelua sipas ligjit (NetzDG) të Gjermanisë dhe mandaton që platformat e mediave sociale të heqin përmbajtjen "qartësisht" të paligjshme brenda 24 orëve dhe përmbajtje të tjera të paligjshme brenda shtatë ditëve, ose do të përballen me gjopa deri në 10 milione euro. Ligji synon të rrisë llogaridhënien dhe të reduktojë anonimitetin për gjuhën e urrejtjes në internet, me qeverinë austriake që të ketë akses në identitetet e përdoruesve në rastet e përmbajtjes së paligjshme.

2.3. Gjermania

Gjermania ka miratuar ligjin NetzDG,⁹ i cili njihet si ligji i censurës dhe ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2018. Miratimi i këtij ligji u shoqërua me kritika të shumta nga ekspertë apo shoqata të ndryshme.¹⁰ Sipas Markus Reuter, ligji NetzDG përmban një klauzolë që u lejon individëve të painedifikuar të indetifikojnë personat e tjerë.¹¹

Një kritikë tjetër është menyra e zbatimit të ligjit.¹² Në këtë ligj parashikohet se kompanitë e mediave online do të fshijnë cdo postim të pahijshëm në mënyrë urgjente brënda 24 orësh ose maksimumi brënda 7 ditësh, pasi në rast të kundërt do të përballen me gjopa në shuma mbi 50 milionë euro. Siç shihet, ligji

⁸ Bundesgesetz, mit dem ein Kommunikationsplattformen-Gesetz erlassen und das KommAustria-Gesetz geändert wird

<https://www.parlament.gv.at/dokument/XXVII/I/463/fnameorig_848584.html#:~:text=C2%A7%204.,behauptete%20rechtswidrige%20Inhalte%20zu%20erstellen> aksesuar më 12 qershor 2024.

⁹ Gesetz zur Verbesserung der Rechtsdurchsetzung in sozialen Netzwerken [2017] <https://www.gesetze-im-internet.de/netzdg/BJNR335210017.html> aksesuar më 13 qershor 2024.

¹⁰ William Echikson and Olivia Knodt, 'Germany's NetzDG: A key test for combatting online hate' (CEPS Research Report November 2018) https://cdn.ceps.eu/wp-content/uploads/2018/11/RR%20No2018-09_Germany's%20NetzDG.pdf aksesuar më 26 qershor 2024.

¹¹ Markus Reuter, 'New Hate Speech Law in Germany: Already Extended Before it Enters Into Force' (March 2017) <https://netzpolitik.org/2017/new-hate-speech-law-in-germany-already-extended-before-it-enters-into-force/> aksesuar më 26 qershor 2024.

¹² Marie-Teresa Weber, 'Bitkom Stellungnahme Zum Referentenentwurf Eines Netzwerkdurchsetzungsgesetzes' (Berlin, 2017) <https://www.bitkom.org/sites/default/files/file/import/FirstSpirit-149275573214220170420-Bitkom-Stellungnahme-zum-Regierungsentwurf-NetzwerkDG.pdf> aksesuar më 26 qershor 2024.

detyron kompaninë që të fshijë postimet. Kjo mënyrë zbatimi zbeh rolin e gjykatës dhe “privatizon” zbatimin e ligjit NetzDG.

2.4. Franca

Në maj të vitit 2020, Franca miratoi një ligj të ngjashëm me modelin gjerman.¹³ Ligji Avia detyroi platformat online që 24 orësh të fshijnë publikimet që nxisin urrejtje apo përmbajnë fyerje diskriminuese për shkak të rracës fesë, përkatësisë etnike, gjinisë, orientimin seksual apo paaftësinë. Në rast të kundërt platformat online sanksionohen me gjobë deri në 250 000 ERU dhe një vit burg për përfaqësuesin ligjor të kompanisë. Gjithashtu, legjislatori francez ka parashikuar edhe gjoba më të mëdha për kompanitë që tejkalojnë një kufi të caktuar që do të përcaktohet me një dekret tjetër. Në këtë, autoriteti administrative mund të gjobisë kompaninë deri në 4% të të ardhurave globale.¹⁴

2.5. Italia

Italia ka ligje që trajtojnë përmbajtje të dëmshme, duke përfshirë postime diskriminuese ose dëmtuese që synojnë të miturit në platformat e mediave sociale. Një ligj i tillë është Kodi Penal Italian, i cili përfshin dispozita që lidhen me shpifjen, shpifjen dhe nxitjen e dhunës ose diskriminimit. Këto dispozita mund të zbatohen për përmbajtjet e dëmshme të postuara në platformat e mediave sociale nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në Kodin Penal.¹⁵

Për më tepër, ka rregulla specifike në Itali që fokusohen në mbrojtjen e të miturve në internet. Për shembull, ligji 71/2017, i njohur gjithashtu si Ligji kundër bullizmit në internet, trajton ngacmimet në internet, ngacmimet dhe sjellje të tjera të dëmshme që synojnë të miturit.¹⁶ Ky ligj vendos detyrime për ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP) dhe platformat e mediave sociale për të marrë masa për të

¹³ Universal Rights Group, ‘France’s watered-down anti-hate speech law enters into force’ <https://www.universal-rights.org/frances-watered-down-anti-hate-speech-law-enters-into-force/> aksesuar më 5 qershor 2024.

¹⁴ European Platform of Regulatory Authorities, ‘Avia Law’ https://www.epra.org/news_items/online-hate-in-france-the-law-avia-an-intensive-legislative-saga-for-a-heavily-censored-law aksesuar më 26 qershor 2024.

¹⁵ Regio Decreto 19 ottobre 1930, n. 1398, Approvazione del testo definitivo del Codice Penale [1930] GU 251.

¹⁶ Legge 71/ 2017, Disposizioni a tutela dei minori per la prevenzione e il contrasto dei fenomeni del bullismo e del cyberbullismo [2017] GU 127.

parandaluar dhe luftuar bullizmin kibernetik, duke përfshirë heqjen e menjëhershme të përmbajtjes së dëmshme.

Për më tepër, Italia ka zbatuar Rregulloren e Përgjithshme të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), e cila përfshin dispozita që synojnë mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të individëve, përfshirë të miturit, në internet.¹⁷ Sipas GDPR, platformat e mediave sociale dhe shërbimet e tjera online duhet të respektojnë rregulla strikte në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, duke përfshirë marrjen e pëlqimit nga prindërit ose kujdestarët për të miturit nën një moshë të caktuar.

Në përgjithësi, megjithëse mund të mos ketë një ligj specifik në Itali që i dedikohet vetëm postimeve në mediat sociale që përmbajnë përmbajtje të dëmshme për të miturit ose përmbajtje diskriminuese, ligje dhe rregullore të ndryshme ekzistuese mund të zbatohen për të adresuar çështje të tilla, veçanërisht kur ato përfshijnë sjellje të dëmshme, diskriminim, ose shkeljet e të drejtave të privatësisë.

3. Analiza e legjislacionit Shqipëtar mbi fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe marrëdhënia me rrjetet sociale

Në vitet e fundit, Shqipëria ka përjetuar një rritje të ndjeshme të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Me përhapjen e digjitalizimit në të gjitha aspektet e jetës, është bërë e domosdoshme që legjislacioni të përshtatet dhe të ketë një evolucion koherent për të garantuar sigurinë, besueshmërinë dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara.

Korniza ligjore e Shqipërisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit përfshin një sërë ligjesh të rëndësishme që synojnë rregullimin dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe bizneseve në këtë sektor. Pjesa e mëposhtme identifikon dhe analizon shkurtimisht kornizën ligjore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

¹⁷ Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation) (Text with EEA relevance) [2016] L 119/1.

i) Ligji nr. 9157 datë 4.12.2003 “Për Përgjimin e Telekomunikimeve” i ndryshuar

Ky ligj përcakton procedurat që duhet të ndiqen për përgjimin e telekomunikimeve nga institucionet shtetërore të autorizuar.¹⁸ Përgjimi i telekomunikimeve është një çështje delikate që kërkon balancimin e interesave të sigurisë kombëtare me të drejtat e privatësisë së individëve. Institucionet e autorizuar duhet të ndjekin procedura të rrepta për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve, duke përfshirë autorizimin nga gjykata dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme për të parandaluar abuzimet.

ii) Ligji nr. 9880 datë 25.2.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik” i ndryshuar

Ky ligj krijon kuadrin e nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e nënshkrimeve elektronike. Ligji për nënshkrimin elektronik ka krijuar bazën për një mjedis më të sigurt dhe të besueshëm për transaksionet digjitale. Nënshkrimi elektronik është një element kyç për transaksionet elektronike, duke garantuar sigurinë dhe besueshmërinë e dokumenteve të nënshkruara në mënyrë digjitale. Në një mjedis gjithnjë e më të digjitalizuar, nënshkrimi elektronik lehtëson procedurat administrative dhe juridike, duke mundësuar një komunikim më të shpejtë dhe më të sigurt.¹⁹

iii) Ligji nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

Ky ligj synon të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturën efiçente në komunikimet elektronike përmes parimit të asnjësisë teknologjike.²⁰ Ai rregullon gjithashtu ofrimin e shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji nuk zbatohet për përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, për pajisjet e komunikimeve të ndërtuara dhe të përdorura ekskluzivisht për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë

¹⁸ Ligji nr. 9157 datë 4.12.2003 “Për Përgjimin e Telekomunikimeve” [2003] FZ 1007 ndryshuar për herë të fundit me Ligjin 69/2017.

¹⁹ Ligji nr. 9880 datë 25.2.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik” [2008] FZ 40 ndryshuar për herë të fundit me Ligjin 25/2024.

²⁰ Ligji nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” [2008] FZ 84 ndryshuar për herë të fundit me Ligjin 92/2019.

kombëtare apo për transmetimet radiotelevizive. Ky ligj ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e infrastrukturës digjitale të vendit, duke garantuar që qytetarët të kenë qasje në shërbime të shpejta dhe të sigurta.

iv) Ligji nr.10 128, datë 11.5.2009 “Për Tregtinë Elektronike”, i ndryshuar

Ky ligj ka për qëllim të krijojë kuadrin ligjor për zhvillimin e tregtisë elektronike dhe shërbimeve të informacionit në rrjetë.²¹ Ai përcakton detyrimet e ofruesve të shërbimeve të informacionit, duke përfshirë platformat online, në lidhje me transparencën, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave të konsumatorëve. Megjithatë ky ligj është ndryshuar për herë të fundit në vitin 2013 dhe nuk rregullon përmbajtjen e krijuar nga përdoruesit, kërkesën për transparencë në lidhje me algoritmet që përdorin platformat për të renditur dhe rekomanduar përmbajtje apo mekanizma të qartë dhe të lehtë për përdoruesit që të raportojnë abuzimet ose të bëjnë ankesa në lidhje me përmbajtjen ose shërbimet e ofruara nga platformat online.

v) Ligji nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për Dokumentin Elektronik” i ndryshuar

Ky ligj rregullon përdorimin e dokumentit elektronik nga personat fizikë, juridikë, publikë dhe privatë. Ai përcakton standardet për krijimin, prodhimin, transmetimin, marrjen, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të dokumenteve elektronike. Me rritjen e përdorimit të dokumenteve elektronike, ky ligj siguron që këto dokumente të jenë të mbrojtura dhe të besueshme, duke lehtësuar kështu procedurat administrative dhe transaksionet ndërmjet institucioneve dhe individëve.²²

²¹ Ligji nr.10 128, datë 11.5.2009 “Për Tregtinë Elektronike” [2009] FZ 85 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 135/2013.

²² Ligji nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për Dokumentin Elektronik” [2010] FZ 58 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 124/2016.

vi) Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

Ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre. Ai zbaton parimin e asnjësisë teknologjike dhe përcakton rregullat për transmetimet audiovizive lineare dhe jolineare, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Në një epokë ku mediat audiovizive kanë një ndikim të madh në formësimin e opinionit publik dhe kulturës, ky ligj garanton lirinë e medias dhe mbrojtjen e interesave të publikut.²³

vii) Ligji nr. 107/2015 datë 1.10.2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara”

Ky ligj përcakton kuadrin e nevojshëm ligjor për identifikimin elektronik të sigurt, vulat elektronike dhe shërbimin e transmetimit elektronik. Ai zbaton gjithashtu skemat e identifikimit elektronik dhe autentifikimin e faqeve të internetit në Republikën e Shqipërisë. Identifikimi elektronik është një komponent kyç për shumë shërbime digjitale, duke përfshirë bankingun dhe shërbimet qeveritare. Ligji për identifikimin elektronik ka krijuar një bazë të fortë për sigurinë e transaksioneve elektronike.²⁴

viii) Ligji nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike

Ky ligj zbatohet për rrjetet e komunikimit dhe sistemet e informacionit që janë thelbësore për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin efektiv të ekonomisë së Republikës së Shqipërisë. Me rreziqet në rritje nga sulmet kibernetike, ky ligj synon të mbrojë rrjetet dhe sistemet e informacionit nga kërcënimet dhe të sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve kritike.²⁵

²³ Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” [2013] FZ 37 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 30/2023.

²⁴ Ligji nr. 107/2015 datë 1.10.2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara” [2015] FZ 182 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 123/2016.

²⁵ Ligji nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike” [2024] FZ 67.

ix) Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”

Ky ligj zbatohet nga autoritetet publike dhe subjektet private për ofrimin e shërbimeve publike në rrugë elektronike. Ai parashikon përdorimin e platformës qeveritare ‘e-Albania’ dhe platformës qeveritare të ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve elektronike. Qeverisja elektronike ka revolucionarizuar mënyrën se si shërbimet publike ofrohen në Shqipëri, duke bërë të mundur që shumë shërbime të aksesohen online pa nevojën e paraqitjes fizike të qytetarëve.²⁶

x) Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, fokusohet në përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Ky ligj ka pësuar ndryshime ndër vite duke u përafruar me përmbajtjen e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave të BE-së (GDPR).

4. Krahasimi i Legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe legjislacionit Shqipëtar mbi fushën e rregullimit të rrjetet sociale

Përparimi i shpejtë i teknologjive dixhitale dhe përhapja e platformave online kërkon mbrojtjen e përdoruesit, konkurrencën e ndershme dhe llogaridhënien e operatorëve të platformës. BE-ja ka krijuar një kuadër ligjor gjithëpërfshirës dhe të avancuar për të rregulluar platformat online, duke

²⁶ Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike” [2023] FZ 99.

përfshirë Aktin e Shërbimeve Dixhitale (DSA)²⁷, Aktin e Tregjeve Dixhitale (DMA),²⁸ GDPR²⁹ dhe Direktivën e Tregtisë elektronike.³⁰

Akti i Shërbimeve Dixhitale (DSA) prezanton një gamë të gjerë detyrimesh për platformat online, veçanërisht duke u fokusuar në moderimin e përmbajtjes, transparencën dhe llogaridhënien. Ai bën dallimin midis llojeve të ndryshme të ndërmjetësve online dhe përshtat detyrimet në përputhje me rrethanat. Dispozitat kryesore përfshijnë raportet e transparencës, masat mbrojtëse procedurale për përdoruesit dhe masat për të luftuar përmbajtjen e paligjshme.

Akti i Tregjeve Dixhitale (DMA) synon platforma të mëdha në internet të përcaktuara si "portierë" dhe vendos rregulla për të parandaluar sjelljen kundër konkurrencës dhe për të siguruar kushte të drejta tregu. Ai përfshin kërkesat për ndërveprim, ndarjen e të dhënave dhe kufizimet në praktikatat e vetë-preferencës.

Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) vendos kërkesa të rrepta për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë, duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si platformat në internet trajtojnë të dhënat e përdoruesit. Kjo rregullore parashikon mekanizma të qartë, të drejtat e subjektit të të dhënave dhe ndëshkime për mospërputhje.

Direktiva për tregtinë elektronike vendos një bazë për përgjegjësinë e ndërmjetësve, duke kërkuar që platformat të veprojnë me shpejtësi pasi të jenë të vetëdijshme për përmbajtje të paligjshme. Po ashtu ofron një port të sigurt për ndërmjetësit që plotësojnë kritere specifike.

²⁷ Regulation (EU) 2022/2065 of the European Parliament and of the Council of 19 October 2022 on a Single Market for Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 277/1;

²⁸ Regulation (EU) 2022/1925 of the European Parliament and of the Council of 14 September 2022 on contestable and fair markets in the digital sector and amending Directives (EU) 2019/1937 and (EU) 2020/1828 (Digital Markets Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 265/1.

²⁹ Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation) (Text with EEA relevance) [2016] OJ L 119/1

³⁰ Directive 2000/31/EC of the European Parliament and of the Council of 8 June 2000 on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market ('Directive on electronic commerce') [2000] OJ L 178/1

Ndërsa Bashkimi Evropian (BE) ka zhvilluar rregullore gjithëpërfshirëse për të adresuar këto fusha, kuadri ligjor shqiptar mbetet relativisht i pazhvilluar. Kuadri ligjor ekzistues nuk përmban dispozita të detajuara që adresojnë përgjegjësinë e ndërmjetësimit, moderimin e përmbajtjes apo kërkesat e transparencës për platformat online. Mungesa e kërkesave të standardizuara për moderimin e përmbajtjes do të thotë se nuk ka rregullim ligjor për identifikimin, rishikimin dhe heqjen e përmbajtjeve të paligjshme ose të dëmshme.

Moderimi dhe përgjegjësia e përmbajtjes

DSA vendos detyrime të qarta për platformat në lidhje me moderimin e përmbajtjes, duke përfshirë raportet e transparencës dhe masat mbrojtëse procedurale për përdoruesit.

Legjislacioni shqiptar nuk ka kërkesa të detajuara për mënyrën sesi platformat duhet të trajtojnë përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme dhe duke ofruar më pak qartësi për përgjegjësinë e ndërmjetësve.

Transparenca dhe llogaridhënia

DSA dhe DMA theksojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë, duke kërkuar që platformat të zbulojnë informacion në lidhje me algoritmet e tyre, praktikatat e reklamimit dhe përpjekjet për të luftuar përmbajtjen e paligjshme. Ky aspekt nuk evidentohet në legjislacionin shqiptar duke rezultuar në mungesë mbikëqyrje dhe llogaridhënie për platformat online që operojnë në vend.

Zbatimi dhe Mbikëqyrja Rregullatore

BE-ja ka krijuar mekanizma të fuqishëm të zbatimit, duke përfshirë gjobat dhe aftësinë për të kufizuar operacionet e platformave që nuk janë në përputhje. Shqipërisë i mungon fuqia e ngjashme e zbatimit, me organe rregullatore që mund të mos kenë burime ose autoritet të mjaftueshëm për të monitoruar dhe sanksionuar në mënyrë efektive platformat online.

5. Rregullimi i *revenge porn* nga disa shtete europiane

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ka një hapësirë ligjore përse i përket një neni specifik mbi ndëshkueshmërinë mbi veprat penale që derivojnë nga përdorimi i rrjeteve sociale, më specifikisht, fenomenit gjithmonë e me shumë në rritje, të quajtur “revenge porn”. Nenet që Kodi Penal përmban mbi krimet seksuale apo krimet kundër moralit dhe dinjitetit, nuk mjaftojnë për ti dhënë përgjigje këtij fenomeni, fenomenit mbi abuzimin e imazheve me përmbajtje seksualisht eksplicite, pa konsensusin e personit të përfshirë në të.³¹ Në disa vende të BE, kjo është e rregulluar. Përkatësisht disa vende të Bashkimit Europian, dënojnë atë fenomen që ndryshe quhet “revenge porn”. Këto vende kanë nene specifike, ku ky fenomen konsiderohet krim.

Më specifikisht, Gjermania ka ligje që kriminalizojnë shpërndarjen e imazheve intime pa pëlqimin e personit të përfshirë në të. Në Seksionin 201a të Kodit Penal Gjerman, trajtohet shpërndarja e paautorizuar e imazheve që shkel jetën personale të personit të paraqitur, apo shpërndarjen e këtyre imazheve nga persona të tretë, duke cënuar dinjitetin dhe moralin e personit, duke e dënuar me burgim jo më shumë se dy vite ose gjobë.

Franca në nenin 226-2-1 të Kodit Penal, jep një dënim rritës me dy vjet burgim dhe një gjobë prej 60.000 Euro kur shkeljet e parashikuara në nenet 226-1 dhe 226-2, përkatësisht kapja, regjistrimi apo transmetimi, përmbajnë fjalë apo imazhe të natyrës seksuale.

Italia në nenin 612, të Kodit Penal, parashikon në mënyrë të detajuar ndalimin e përhapjeve të imazheve me përmbajtje seksualisht eksplicite pa pëlqimin e personit të përfshirë në të, si dhe dënimet përkatëse që variojnë nga një deri në gjashtë vite burgim, dhe gjoba që shkojnë deri në 15.000 euro. Ligji dënon jo vetëm personat krijues të këtyre imazheve, por dhe persona të tretë që i shpërndajnë ato.

³¹ Ligji nr 7895, datë 27.01.1995, ‘Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë’ [1995] FZ 2 i ndryshuar për here të fundit me Ligjin nr 20, datë 3.4.2024, Kreu II, Seksioni VI (nenet 100-108a) dhe Seksioni VIII (nenet 113-123).

Spanja në nenin 197.7 të Kodit Penal, flet për shpërndarje të imazheve apo audiove private të një personi, që ndikojnë në jetën private të atij individi, dhe e dënon atë me dënim me burg në varësi të shkeljes.

Suedia në kapitullin 4, seksionin 4a të Kodit të tyre Penal, e bëri të paligjshme në vitin 2018 shpërndarjen e imazheve intime pa pëlqimin, të dënueshme me gjobë ose burgim.

Të gjitha këto vende të Bashkimit Europian, kanë marrë masa mbi këtë fenomen kaq sensitiv dhe gjithnjë e më shumë në rritje, që prek dinjitetin e personit, moralin e tij, denigron figurën, dhe në rastet më fatale shkakton dhe vetëvrasje.

6. Konkluzionet

Pavarësisht rregullimit ligjor të një pjese të mirë të horizontit të teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit, qartazi ndihet mungesa e dispozitave ligjore të cilat do të mund të kenë aftësi kontrolluese dhe mbarëvajtëse mbi një ndër fushat më prezente të teknologjisë në jetën tonë, rrjetet sociale. Hapësira ligjore e një rregullimi të qartë dhe të detajuar për këto platforma në legjislacionin shqiptar përbën një sfidë të rëndësishme. Pa një kuadër ligjor konkret, ekzistojnë rreziqe të shumta që mund të ndikojnë negativisht shoqërinë dhe individët.

Një nga rreziqet kryesore të mediave sociale është keqpërdorimi i të dhënave personale. Platformat online shpesh mbledhin një sasi të madhe të dhënash nga përdoruesit e tyre. Këto të dhëna përfshijnë informacione personale, preferenca dhe sjellje të përdoruesve, të cilat mund të përdoren për qëllime komerciale, politike ose të tjera. Në mungesë të një legjislacioni të rreptë që rregullon përdorimin dhe mbrojtjen e këtyre të dhënave, ekziston rreziku që ato të përdoren pa pëlqimin e individëve, duke cënuar privatësinë dhe sigurinë e tyre.

Një tjetër rrezik është përhapja e dezinformimit dhe lajmeve të rreme. Mediat sociale shpesh përdoren për të shpërndarë informacione të pavërteta ose të shtrembëruara, të cilat mund të kenë pasoja serioze. Dezinformimi mund të ndikojë në perceptimin publik dhe të destabilizojë proceset

demokratike. Në raste ekstreme, lajmet e rreme mund të krijojnë panik dhe të çojnë në reagime të panevojshme dhe të dëmshme nga publiku.

Ngacmimet dhe bullizmi online përbëjnë një tjetër problematikë. Platformat sociale ofrojnë një hapësirë ku individët mund të ngacmojnë dhe të abuzojnë të tjerët pa u përballur me pasoja të menjëhershme. Kjo ka sjellë një rritje të ndjeshme të ngacmimeve dhe bullizmit online, të cilat mund të kenë ndikime të rënda psikologjike dhe emocionale për viktimat, veçanërisht për të rinjtë dhe fëmijët.

Për më tepër, radikalizimi dhe ekstremizmi online janë rreziqe të mëdha që kërkojnë vëmendje të veçantë. Platformat sociale mund të përdoren nga grupe ekstremiste për të rekrutuar dhe radikalizuar individë të rinj. Duke shfrytëzuar hapësirat e pakontrolluara të internetit, këto grupe shpërndajnë propagandë dhe ideologji të dhunshme, duke krijuar një mjedis të rrezikshëm për sigurinë publike.

Në mungesë të një rregullimi të qartë ligjor, platformat sociale mund të përdoren për aktivitete të paligjshme, si trafikimi i qenieve njerëzore, shitja e drogës dhe përhapja e materialeve të paligjshme. Këto aktivitete jo vetëm që shkelin ligjin, por gjithashtu përbëjnë një rrezik të madh për sigurinë dhe mirëqenien e individëve dhe komuniteteve.

Për të adresuar këto rreziqe, është thelbësore që Shqipëria të miratojë një ligj specifik për rregullimin e platformave të mediave sociale. Ky ligj duhet të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve, si dhe përgjegjësitë e platformave për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat personale të përdoruesve. Gjithashtu, ligji duhet të parashikojë mekanizma efektivë për monitorimin dhe zbatimin e rregullave, për të garantuar që platformat të veprojnë në përputhje me standardet e larta të sigurisë dhe etikës.

Sugjerim për Kodin Penal

Një aspekt tjetër ku vërehet mungesë ndëshkueshmërie për veprat që rrjedhin nga përdorimi i rrjeteve sociale është Kodi Penal. Në Kodin Penal aktual nuk ekziston asnjë nen që i përgjigjet veprave si shpërndarja, publikimi dhe kërcënimi me foto apo video që shfaqin persona të angazhuar në aktivitete seksuale, në poza seksualisht eksplicite, me gjenitale të ekspozuara, pamje në të cilat personi i përfshirë nuk kishte për qëllim publikimin e tyre, pra pa pëlqimin e tij.

Ky fenomen është shpesh një përgjigje ndaj një ndarjeje, pra një hakmarrje nga një ish-bashkëshort, bashkëjetues apo nga një person me të cilin viktimja ka pasur marrëdhënie emocionale. Ky fenomen, poshtërues për imazhin dhe dinjitetin, mund të kushtëzojë jetën e viktimës.

Kodi aktual penal parashikon ndëshkueshmërinë për krimet seksuale, veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit, por nuk ofron asgjë që adreson drejtpërdrejt këtë problematikë. Me rritjen e vazhdueshme të këtij fenomeni, lind nevoja për një parashikim specifik që dënon këto lloj sjelljesh dhe pasojat që vijnë me to. Duhet patur parasysh se të gjitha nenet ekzistente në Kodin Penal nuk lidhen me publikim të këtyre pamjeve me dëshirë, por me qëllim hakmarrës ndaj viktimës e cila në mirëbesim ia ka dërguar vetëm autorit tëveprës materialet.

Si rezultat, bazuar në modelin Italian (nenin 612 i Kodit Penal Italian), propozimi ynë konsiston në parashikimin e një neni mbi "Publikimin dhe shpërndarjen e imazheve apo videove private seksualisht eksplicite". Ky nen do të synonte të dënonte autorët e kësaj sjelljeje, duke përfshirë personat që angazhohen në publikimin dhe përhapjen e tyre, veprim që ka për qëllim denigrimin e figurës së personit dhe shkaktimin e një dëmi mbi figurën e tij si dhe psikologjinë.

7. Referencat

- Ariff, Nor Zaina Zaharah Mohamad. et al. (2018). The Benefits of Using Social Media and the Impact of not filtering the Information. *International Journal of Academic Research in Progressive Education and Development*, 7(3), 304–313
- BBC, “Molly Russell: Coroner's report urges social media changes” <https://www.bbc.com/news/uk-england-london-63254635> aksesuar më 14 qershor 2024.
- BBC, “Molly Russell: Tech firms still failing after teenager's death, says father” <<https://www.bbc.com/news/uk-67556756>> aksesuar më 14 qershor 2024
- Bundesgesetz, mit dem ein Kommunikationsplattformen-Gesetz erlassen und das KommAustria-Gesetz geändert wird <https://www.parlament.gv.at/dokument/XXVII/I/463/fnameorig_848584.html#:~:text=%C2%A7%204.,behauptete%20rechts%20Inhalte%20zu%20erstellen> aksesuar më 12 qershor 2024
- Commission, *Digital Services Act* <<https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/digital-services-act-package>> aksesuar më 12 qershor 2024.
- Directive 2000/31/EC of the European Parliament and of the Council of 8 June 2000 on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market ('Directive on electronic commerce') [2000] OJ L 178/1
- Echikson William and Knodt Olivia, 'Germany's NetzDG: A key test for combatting online hate' (CEPS Research Report November 2018) https://cdn.ceps.eu/wp-content/uploads/2018/11/RR%20No2018-09_Germany's%20NetzDG.pdf aksesuar më 26 qershor 2024
- European Platform of Regulatory Authorities, 'Avia Law' https://www.epra.org/news_items/online-hate-in-france-the-law-avia-an-intensive-legislative-saga-for-a-heavily-censored-law aksesuar më 26 qershor 2024
- Ellison Nicole B, et al (2007) The Benefits of Facebook “Friends:” Social Capital and College Students' Use of Online Social Network Sites, *Journal of Computer-Mediated Communication*, Volume 12, Issue 4, 1 July 2007, Pages 1143–1168
- Gesetz zur Verbesserung der Rechtsdurchsetzung in sozialen Netzwerken [2017] <https://www.gesetze-im-internet.de/netzdg/BJNR335210017.html> aksesuar më 13 qershor 2024
- Hoxha Ilda, 'Dhuna në rrjetet sociale po rrit agresivitetin dhe bullizmin në shkollë' <https://faktoje.al/dhuna-ne-rrjetet-sociale-po-rrit-agresivitetin-dhe-bullizmin-ne-shkolla/> aksesuar më 11 qershor 2024
- Hoxhaj Ermelinda, 'Të tallur dhe të dhunuar: Kriza e bullizmit në shkollat shqiptare' (26 shkurt 2024) <https://www.reporter.al/2024/02/26/te-tallur-dhe-te-dhunuar-kriza-e-bullizmit-ne-shkollat-shqiptare/> aksesuar më 11 qershor 2024.
- Indeksonline, “Austria, ligj të veçantë për regjistrimin e përdoruesve të internetit” <https://indiksonline.net/austria-ligj-te-vecante-per-regjistrimin-e-perdoruesve-te-internetit/> aksesuar më 10 qershor 2024.
- Kallxo (2024). “Ligji i ri për KPM0-në synon të vë në rregull videot e mediave online”. Marrë nga <https://kallxo.com/lajm/ligji-i-ri-per-kpm-ne-synon-te-ve-rregull-ne-videot-e-mediave-online/>
- Ligji nr 7895, datë 27.01.1995, 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë' [1995] FZ 2 i ndryshuar për here të fundit me Ligjin nr 20, datë 3.4.2024

- Legge 71/2017, Disposizioni a tutela dei minori per la prevenzione e il contrasto dei fenomeni del bullismo e del cyberbullismo [2017] GU 127
- Ligji nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për Dokumentin Elektronik” [2010] FZ 58 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 124/2016
- Ligji nr. 107/2015 datë 1.10.2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara” [2015] FZ 182 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 123/2016
- Ligji nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike” [2024] FZ 67
- Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike” [2023] FZ 99
- Ligji nr. 9157 datë 4.12.2003 “Për Përgjimin e Telekomunikimeve” [2003] FZ 1007 ndryshuar për here të fundit me Ligjin Ligjin 69/2017
- Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” [2013] FZ 37 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 30/2023
- Ligji nr. 9880 datë 25.2.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik” [2008] FZ 40 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 25/2024
- Ligji nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” [2008] FZ 84 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 92/2019
- Ligji nr.10 128, datë 11.5.2009 “Për Tregtinë Elektronike” [2009] FZ 85 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 135/2013
- Lin Liu yi B.A., et al, (2017) Association Between Social Media Use and Depression Among U.S. Young Adults, Depression and Anxiety <https://doi.org/10.1002/da.22466>
- Petrosyan Ani, ‘Number of internet and social media users worldwide as of April 2024’
<https://www.statista.com/statistics/617136/digital-population-worldwide/#:~:text=As%20of%20April%202024%2C%20there,population%2C%20were%20social%20media%20users> aksesuar më 13 qershor 2024.
- Regio Decreto 19 ottobre 1930, n. 1398, Approvazione del testo definitivo del Codice Penale [1930] GU 251.
- Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation) (Text with EEA relevance) [2016] L 119/1
- Regulation (EU) 2022/1925 of the European Parliament and of the Council of 14 September 2022 on contestable and fair markets in the digital sector and amending Directives (EU) 2019/1937 and (EU) 2020/1828 (Digital Markets Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 265/1
- Regulation (EU) 2022/2065 of the European Parliament and of the Council of 19 October 2022 on a Single Market for Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 277/1
- Reuter Markus, ‘New Hate Speech Law in Germany: Already Extended Before it Enters Into Force’ (March 2017) <https://netzpolitik.org/2017/new-hate-speech-law-in-germany-already-extended-before-it-enters-into-force/> aksesuar më 26 qershor 2024
- Universal Rights Group, ‘France’s watered-down anti-hate speech law enters into force’ <https://www.universal-rights.org/frances-watered-down-anti-hate-speech-law-enters-into-force/> aksesuar më 5 qershor 2024
- Weber Marie-Teresa, ‘Bitkom Stellungnahme Zum Referentenentwurf Eines Netzwerkdurchsetzungsgesetz’ (Berlin, 2017) <https://www.bitkom.org/sites/default/files/file/import/FirstSpirit->

Deklarata e Autorëve

Ky punim është përgatitur në kuadër të projektit “Jo Korrupsionit, Po Demokracisë”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me financim të Qeverisë Suedeze, nën mentorimin e Dr. Gentjan Skara.

Kontributi i studentëve në këtë punim është si vijon:

Seksioni 1 “Hyrje”: Artemis Senja dhe Megi Musabelliu

Seksionin 2 “Analiza e legjislacionit të BE-së dhe disa shteteve anëtare mbi rregullimin e platformave online” Artemis Senja, Megi Musabelliu dhe Vesa Muka

Seksionin 3 “Analiza e legjislacionit Shqipëtar mbi fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe marrëdhënia me rrjetet sociale” Greta Deliallisi, Katerina Çela, Lea Kryeziu, Leonardo Bezhi dhe Oresta Xhengo

Seksioni 4 “Krahasimi i Legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe legjislacionit Shqipëtar mbi fushën e rregullimit të rrjetet sociale” Katerina Çela

Seksioni 5 “Rregullimi i revenge porn nga disa shtete europiane” Lea Kryeziu

Seksioni 6 “Konkluzionet” Artemis Senja, Megi Musabelliu Megi, Greta Deliallisi, Katerina Çela, Lea Kryeziu dhe Oresta Xhengo